

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI

VENDIM

Nr. 1, datë 27.01.2017

“PËR

**KRITERET E PRANIMEVE NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE PËR
PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË PËR VITIN AKADEMIK 2017-
2018, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS”**

Mbështetur në Ligjin Nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Senati në mbledhjen e datës 27.01.2017,

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve të pranimeve në programet e studimit të ciklit të parë dhe për programet e integruara të studimit të ciklit të dytë për vitin akademik 2017-2018, në Universitetin Politeknik të Tiranës si më poshtë vijon:

a. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike:

- i. Bachelor në Inxhinieri Mekanike
- ii. Bachelor në Inxhinieri Materiale
- iii. Bachelor në Inxhinieri Tekstili dhe Modë
- iv. Bachelor në Inxhinieri Ekonomike

b. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike:


- i. Bachelor në Inxhinieri Elektrike-Profil i Automatizim i Industrisë
- ii. Bachelor në Inxhinieri Elektrike-Profil i Energjitikë
- iii. Bachelor në Inxhinieri Mekatronike

c. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit

- i. Bachelor në Inxhinieri Elektronike
- ii. Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni
- iii. Bachelor në Inxhinieri Informatike

d. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit

- i. Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi
- ii. Bachelor në Inxhinieri Hidroteknikë
- iii. Bachelor në Inxhinieri Mjedis
- iv. Bachelor në Inxhinieri Gjeodezi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI

e. Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës

- i. Pr.IntegrUAR studimi, Master i Shkencave në Arkitekturë-Profil i Arkitekt
- ii. Pr.IntegrUAR studimi, Master i Shkencave në Arkitekturë-Profil i Urbanist
- iii. Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn

f. Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave

- i. Bachelor në Inxhinieri Gjeoinformatikë
- ii. Bachelor në Inxhinieri Gjeoburime
- iii. Bachelor në Inxhinieri Gjeomjedi
- iv. Bachelor në Shkenca Toke

g. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike:


- i. Bachelor në Inxhinieri Matematike
- ii. Bachelor në Inxhinieri Fizike

2. Kandidatët duhet të kenë mesataren e shkollës së mesme mbi 6 (gjashtë).
3. Përzgjedhja e kandidatëve, që do të aplikojnë në një program studimi, do të bëhet duke ju referuar në masën 70% notës mesatare të shkollës së mesme, sipas kriterit të notës mesatare të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2017-2018, sipas Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë" neni 74, pika 1, si dhe në masën 30% mesatare aritmetike të peshuara të tre lëndëve Matematike, Fizike dhe Kimi, në të tre vitet e shkollës së mesme sipas koeficientëve të dhëna në formulën e mëposhtme. Rezultati i vlerësimit të mësipërm do të ponderohet me koeficientin e shkollës së mesme, të përcaktuar për çdo program studimi, sipas specifikave të tyre dhe të publikuar nga UPT:

$$[0.7 * Mes_{VKM} + 0.3(0.5 * Mes_{Matematike} + 0.4 * Mes_{Fizike} + 0.1 * Mes_{Kimi})] * K_{koef. Shkollës} * 1000$$

Ku:

Mes_{VKM}, nota mesatare e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2017-2018, sipas Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI

e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë” neni 74, pika 1;

Mes *Matematike*, nota mesatare e thjeshtë e matematikës në të gjitha vitet e shkollës së mesme përfshirë rezultatin në Maturën Shtetërore në provimet e detyruara dhe në provimet me zgjedhje;

Mes *Fizike*, nota mesatare e thjeshtë e fizikës në të gjitha vitet e shkollës së mesme përfshirë rezultatin në Maturën Shtetërore të provimit me zgjedhje;

Mes *Kimi*, nota mesatare e thjeshtë e kimisë në të gjitha vitet e shkollës së mesme përfshirë rezultatin në Maturën Shtetërore të provimit me zgjedhje;

K*koef. Shkollës*, koeficienti i shkollës së mesme, për vitin akademik 2017-2018, sipas tabelës së koeficientëve për vitin akademik 2017-2018, bashkëlidhur.

Bashkëlidhur gjeni tabelat e koeficientëve të shkollave sipas Fakulteteve dhe programeve të studimit.

KRYETARI

Prof. Dr. Andrea MALIQARI